

Bazuar në Ligjin nr, 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 75, VKA nr. 5, datë 14.8.2020 “Për shtesa e ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për Personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” dhe në Urdhërin nr. 32 prot., datë 01.12.2023, të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, DRSSH Durrës shpall vend të lirë pune për pozicionin:

### **DRSSH Durrës**

1. Inspektor për të vetëpunësuarit në bujqësi / ALSSH Shijak  
1 vend pune

#### **Kandidati konkurues:**

- Duhet të zotërojë diplomë të Nivelit të Parë / Bachelor ose të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Të ketë të paktën 2 vjet punë në administratë publike / shërbim civil, ose minimumi dy vjet punë në sektorin privat në profesion.

#### **Kërkesat e përgjithshme specifike**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista**

- Njohuritë në fushën e sigurimeve shoqërore (statusi i ISSH-së, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar);
- Njohuri të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare dhe personelit;
- Njohuri të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";
- Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b) vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- c) intervista me gojë, ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkurohet.

**Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:**

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, **deri në 20 pikë;**
- b) për intervistën me gojë, **deri në 40 pikë;**
- c) për vlerësimin me shkrim, **deri në 40 pikë.**

Kandidati konkurues kualifikohet nëse në total ka fituar mbi **70 pikë**, nga 100 pikë të mundshme, gjatë fazës së vlerësimit.

**Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat në zyrën e protokollit të DRSSH Durres, si më poshtë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin janë të interesuar;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë
- Fotokopje të librezës së punës;
- Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të Kartës së identitetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet **brenda datës 11.12.2023** pranë zyrës së protokoll/sekretarisë në DRSSH Durres.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

**Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH-së Durres në datën **18.12.2023, ora 10.**

**Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH-së Durres në datën **22.12.2023, ora 10.**